



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 30 shtator 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1291\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 75 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 19.08.2020 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.**, adresa: Rr. 17 Shkurti, Kati 5 Model Slovenia H1., Fushë Kosovë, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur me datë 30 shtator 2020, nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. I LËSHOHET** Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.**, me numër licence **ZRRE/Li\_68/20** për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data **30 shtator 2020** deri **29 shtator 2025**.
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.**, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.



## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 19.08.2020 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.**
  - Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duhet dërguar në Rregullatori dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
  - Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.** me datë 21 shtator 2020 ka njoftuar përmes gazetës palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
  - Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditë kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
  - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **BINDI INTEGRATED SERVICES SH.P.K.**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Seffijaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar